



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, më 11 shkurt 2022  
Nr.ref.:RK 1944/22

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI178/21**

Parashtrues

**Agim Stublla**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit  
PA1. nr. 877/2021, të 16.09.2021**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Agim Stublla, (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) nga fshati Lluzhan, Komuna e Podujevës.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit PA1. nr. 877/2021, të 16 shtatorit 2021, si dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-dega në Podujevë P. nr. 74/2016 të 23 qershorit 2017.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesi i kërkesës nuk ka deklaruar qartë se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) konsideron se i janë shkelur me vendimin e kontestuar.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 5 tetor 2021, parashtruesi i kërkesës përmes postës elektronike e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 18 tetor 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha.
7. Më 18 tetor 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Përmes së njëjtës shkresë, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës ta dorëzojë formularin e plotësuar të kërkesës dhe t'i specifikoj pretendimet e tij.
8. Më 21 tetor 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë pro jo edhe formularin e kërkesës dhe as shpjegimin e kërkuar.
9. Më 25 tetor 2021, Gjykata e njoftoi Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës dhe i dorëzoi të njëjtës një kopje të kërkesës.
10. Më 20 janar 2022, pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Më 27 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës dhe bashkëshortja e tij duke punuar në pronën e tyre shkaktuan zjarr, i cili u përhap në pronat fqinje dhe shkaktoi dëme materiale.

12. Më 11 janar 2016, Prokuroria Themelore në Prishtinë ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë PP/nr. 6197/2013, kundër parashtruesit të kërkesës dhe bashkëshortes së tij, për shkak të dyshimit të bazuar se kishin kryer veprën penale zjarrvënie.
13. Më 23 qershor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë, nxori Aktgjykimin P. nr. 74/2016 me të cilin parashtruesi i kërkesës dhe bashkëshortja e tij janë shpallur fajtorë për veprën penale të zjarrvënies, dhe janë dënuar me kusht 6 (gjashtë) muaj, dënimi nuk do të ekzekutohet brenda 1 (një) viti, nëse i dënuari nuk kryen një vepër të re gjatë asaj periudhe.
14. Më 2 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit, duke deklaruar se asnjëherë nuk e ka pranuar aktgjykimin P.br.74/2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë.
15. Më 16 shtator 2021, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin PA1. nr. 877/2021, përmes të cilit refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të paafatshme.
16. Në pjesën përkatëse të arsytimit të aktvendimit, Gjykata e Apelit theksoi:

*“ [...] pasi që të akuzuarve pas tentimit për t'ua dërguar aktgjykimin personalisht, i cili ka dështuar për shkak se palët nuk janë gjendur aty, Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë, ka nxjerrë aktvendimin P. nr. 74/2016, me dt. 27.07.2017, me të cilin dorëzimi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P. nr. 74/2016 të dt. 23.06.2017, të vihet në stendën e shpalljeve të gjykatës, dhe me skadimin e afatit prej S ditësh nga dita e vënies në stendën e gjykatës, dërgesa do të konsiderohet valide. Me këtë rast, afati për ushtrimin e ankesës ka filluar të rrjedhë nga dt. 27.07.2017, kur aktgjykimi është shpallë në stendën e gjykatës, kurse i akuzuari Agim Stublla, ankesë ka ushtruar me dt. 02.07.2021, që nënkupton pas kalimit të afatit për ushtrimin e të njëjtës, andaj duke pasur parasysh dispozitat përkatëse ligjore, kur ankesa është ushtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, gjykata e hedh të njëjtën me aktvendim si të pasafatshme.”*

17. Parashtruesi i kërkesës kundër vendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit [PA1. nr. 877/2021] të 16 shtatorit 2021, paralelisht me kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, gjithashtu kishte parashtruar kërkesë në Gjykatën Supreme duke kontestuar vendimin e njëjtë.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

18. Parashtruesi i kërkesës nuk ka deklaruar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore i janë shkelur me vendimin e kontestuar.
19. Parashtruesi i kërkesës pretendon, *“kërkoj nga Gjykata Supreme të zbatohet ligji, të kam të drejtën time themelore, në të drejtën në ankesë, që është e drejta themelore e procesit, dhe e procedurës gjyqësore, kërkoj shqyrtim gjyqësor, dhe vendosje në bazë të ligjit, mbi procedurën gjyqësore, sepse gjykata themelore Prishtinë, dega në Podujevë ka shkelë ligjin e procedurës penale”*.

20. Më tej, parashtruesi i kërkesës pretendon *“I jam drejtuar edhe Gjykatës së Apelit përmes Gjykatës Themelore, Degës në Podujevë dhe përmes postës direkte dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës përmes postës. Shkeljen e ligjit e ka mbështetur edhe Gjykata e Apelit, ku më ka dërguar aktvendimin me postë, më 05.10.2021, aktvendimin PA1. nr. 877/2021, të njëjtën ditë kur e kam pranuar aktvendimin përmes postës, kam parashtruar ankesë drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, përmes postës dhe brenda afatit ligjor. Kërkoj nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës të anulojë aktgjykimin dhe vendimin dhe ta kthejë lëndën në rishqyrtim dhe rigjykim”*.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

21. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.
22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

*„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

23. Gjykata i referohet edhe kriterëve të pranueshmërisë siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit, i cili përcakton:

#### Neni 47 [Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*“2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

24. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

(...)

“(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar”.

25. Gjykata rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës, i obligon personat fizikë dhe juridikë që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive që janë në dispozicion, kundër një aktgjykimi ose vendimi të kontestuar.
26. Në këtë mënyrë, organeve administrative dhe gjykatave të rregullta u jepet mundësia që të parandalojnë dhe korrigjojnë shkeljet eventuale kushtetuese përmes procedurave të rregullta administrative dhe gjyqësore, para se rasti të vijë në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete juridike efektive për parandalimin, përkatësisht korrigjimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të mekanizmit të drejtësisë kushtetuese (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI67/19, parashtrues *Hajrije Rina Zhitija Ajeti*, Aktvendim për papranueshmëri i 30 shtatorit 2019, paragrafi 34; KI09/19, parashtrues *Leutrim Hajdari*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 marsit 2020, paragrafi 36; KI30/17, parashtrues *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 gushtit 2017, paragrafi 35; dhe KI94/14, parashtrues *Sadat Ademi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2014, paragrafi 24).
27. Në lidhje me këtë, Gjykata vë në dukje qëndrimin konsistent se mekanizmi mbrojtës për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese ka karakter subsidiar, në raport me sistemin e rregullt gjyqësor (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI15/16, parashtruesi i kërkesës *Ramadan Muja*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 marsit 2016, paragrafi 42).
28. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të ketë mundësi të shfrytëzojë mjetet juridike të cilat janë të disponueshme dhe të mjaftueshme për të korrigjuar shkeljet e pretenduara kushtetuese. Ekzistimi i mjeteve juridike në fjalë duhet të jetë mjaft i sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, dhe nëse nuk është kështu, atëherë këtyre mjeteve juridike do t’iu mungojë disponueshmëria dhe efektiviteti i nevojshëm. Kjo është në përputhje edhe me praktikën e GJEDNJ-së, lidhur me detyrimin e parashtruesve të kërkesave për të shteruar mjetet juridike (shih, *inter alia*, *Vernillo kundër Francës*, paragrafi 27 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 20 shkurtit 1991, dhe *Dalia kundër Francës*, paragrafi 38 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 19 shkurtit 1998).
29. Rrjedhimisht, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse mjetet juridike janë shteruar dhe, nëse jo, a kishte parashtruesi i kërkesës në dispozicion mjet juridik efektiv, në teori dhe praktikë. Pra, Gjykata duhet të sigurojë që mjeti juridik ka qenë i qasshëm dhe ka ofruar mundësi të arsyeshme të korrigjojë shkeljet eventuale kushtetuese të pretenduara nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Kushtetuese (shih, po ashtu, rastin e lartcekur të Gjykatës nr. KI41/20, parashtrues i kërkesës *Shaqir Krasniqi*, paragrafi 23; dhe shih, *inter alia*, *Civet kundër Francës*, paragrafët 42-44 të Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 28 shtatorit 1999).

30. Megjithatë, në rastet kur mjete juridik parashikohet me ligj, i takon parashtruesit të kërkesës të dëshmojë që mjete juridik i parashikuar me ligj ishte shteruar me të vërtetë, apo për ndonjë arsye ishte i paqasshëm dhe joefektiv në rrethanat konkrete të rastit, apo se kanë ekzistuar rrethanat e veçanta për shkak të të cilave parashtruesi i kërkesës ishte i liruar nga kërkesa e shterimit të mjeteve juridike.
31. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kundër vendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit [PA1. nr. 877/2021] të 16 shtatorit 2021, paralelisht me kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, parashtruesi i kërkesës gjithashtu kishte parashtruar kërkesë në Gjykatën Supreme duke kontestuar vendimin e kontestuar. Në dritën e kësaj, Gjykata dëshiron të theksojë pretendimin e parashtruesit të kërkesës se *“shkeljen e ligjit e ka mbështetur edhe Gjykata e Apelit, ku më ka dërguar aktvendimin me postë, më 05.10.2021, aktvendimin PA1. nr. 877/2021, të njëjtën ditë kur e kam pranuar aktvendimin përmes postës, kam parashtruar ankesë drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Gjykatës Kushtetuese të Kosovës”*.
32. Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar se mjete juridik i përmendur nga parashtruesi i kërkesës – përkatësisht padia në Gjykatën Supreme - nuk është mjet efektiv në rastin e tij.
33. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit duhet të deklarohet e papranueshme, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.



## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës, më 20 janar 2022, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Gresa Caka-Nimani